



Republika e Kosovës



Komuna e Istogut

KONTRATË PËR SHËRBIME

KOMUNA E ISTOGUT, ZYRA E PROKURIMIT, të cilën e perfaqëson Menaxheri-ja e Prokurimit z. Zizë Bujupaj, Rruga “Fadil Ferati” në njërën anë;

Dhe

”Nezir Prokshi” B.I me emër tregtar Shtëpia Botuese “MESHARI” NRB 811175167 me nga Prishtina të cilën e perfaqëson z. Nezir Prokshi, në cilësinë e Drejtorit të ndermarrjës nga ana tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për:

TITULLI I KONTRATËS:

BOTIMI I KATALOGUT ME PUNË ARTISTIKE PËR NXËNËS TE SHKOLLAVE

Nr. I prokurimit	633 – 019 - 4027- 2-3-6 / C-230
I brendshëm	633 - 019 - 049 -236

Neni 1

Lënda

1.1 BOTIMI I KATALOGUT ME PUNË ARTISTIKE PËR NXËNËS TE SHKOLLAVE

1.2 Kontrata hynë në fuqi me 28.08.2019 dhe përfundon me 18.09.2019

1.3 Afati kohor i kryerjes së FURNIZIMEVE nuk mund të jetë më shumë se 20 ditë nga data e nënshkrimit të Kontratës.

1.4 Vendi i kryerjes së shërbimeve do të jetë Drejtorati për Rini Kulturë e Sport i Komunës së Istogut.

Neni 2

Ligji i aplikueshëm

2.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë sipas Nenit 40 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 Për çështjet që nuk mbulojnë me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.

Neni 9 Inspektimi dhe testimi

9.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshtërinë, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar.

Neni 10 Nën-kontraktimi

10.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Operatori Ekonomik nuk duhet të nënkontrakttojë pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

Neni 11 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

11.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c). Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e). Falimenton; f). Është dënuar nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res-judicata*; g) Operatori ekonomik i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës.

Neni 12 Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik

12.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorin Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 180 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

Neni 13 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

13.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund t'i drejtohet, Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik,

13.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në *Tribunalin e Perehershëm i Arbitrazhit pranë Odës Ekonomike të Kosovës.*

Neni 14 Komunikimi

14.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet ta jap Titullin e kontratës dhe numrin i identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.

E hartuar në gjuhën Shqipe në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një original për Operatorin Ekonomik.

Për: Autoritetin Kontraktues
Komuna e Istogut

Për: Kontraktorin
B.I. Nezir Prokshi
SH. B. "MESHARI"

Emri: <i>per</i> Zize Bujupaj		Nezir Prokshi B.I.
Pozita: Zyrtar Përgjegjës i Prokurimit	Pozita:	M e n a x h e r
Nënshkrimi: 	Nënshkrimi: 	
Data: 29.08.2019	Data: 29.08.2019	
Vula: 	Vula: 	

PERSHKRIMI | KATALOGUT DHE PERSHKRIMI | ÇMIMEVE

PERSHKRIMI	ÇMIMI
FORMATI 22X21:5	1,314.00 Eur.
TIRAZHI 300 EKZEMPLARE	
SHTYPI COLOR DHE BARDH E ZI	
DUHET TI KETE MIN.114 FAQE	
KATALOGU KA 136 PUNIME ARTISTIKE	
KOPERTINAT E TRASHA	



[Handwritten signature]